



KUVENDI

Ekstrakt

**nga procesverbali i mbajtur më 25 maj 2016, në mbledhjen e XXIX-të (njëzetënëntë)
– e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës.**

Mbledhja filloi në orën 10:05 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët e Kuvendit, përveç znj.Mrikë Thaqi dhe z.Xhevdet Beselica të cilët munguan.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe z.Agim Veliu Kryetar i Komunës, z.Nexhmi Rudari Nënkrjetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

➤ **Rishikimi i buxhetit të Komunës për vitin 2016**

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, përshëndeti të pranishmit, theksoi, kjo mbledhje është e jashtëzakonshme dhe është thirrur në bazë të instruksionit nga Ministria e Financave. Për shkak të afatit nuk ka pasur mundësi të thirret dhe të përgatitet materiali rreth rishikimit të buxhetit për mbledhje të rregullt. Fillimisht lidhur me temën fjalën e ka z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, ndërsa shkurtimisht edhe Drejtorët e Drejtorive që kanë të bëjnë me projektet mund të arsyetojnë propozimet për rishikim.

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër tjera theksoi, Qeveria e Republikës së Kosovës bazuar në dispozitat përkatëse ligjore ka lëshuar Instruksionin për rishikimin e Buxhetit për vitin 2016. Bazuar në këtë Instruksion Qeveria kërkon nga Organizatat buxhetore në nivel vendi që të identifikojnë kursimet e mundshme nëpër të gjitha kategoritë ekonomike për të mbuluar iniciativë të reja. Rishikimi i buxhetit ofron mundësi për transfer të mjeteve ndërmjet programeve. Sipas Instruksionit organizatat buxhetore do të lejohen të bëjnë rregullime të brendshme, që janë të arsyeshme për të bërë ekzekutimin efikas të buxhetit për periudhën e mbetur të vitit fiskal. Me rishikim nuk lejohet transfer i mjeteve ndërmjet kategorive ekonomike përveç në raste të veçanta. Drejtori në vazhdim foli kriteret dhe përkufizimet sipas instruksionit dhe paraqiti sqarimet lidhur me propozimet e rishikimit të buxhetit nëpër të gjitha kategoritë ekonomike në Drejtoritë përkatëse, si dhe për shumat e mjeteve buxhetore të propozuara.

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit (DSHPMSH), theksoi, bazuar në Instruksionin e Ministrisë së Financave, DSHPMSH ka bërë propozimin e rishikimit të buxhetit brenda buxhetit që ka, nuk ka buxhet shtesë nga programet tjera. Buxheti i rishikuar në projektet që i keni në tabelë është 6.68 % e buxhetit të përgjithshëm, e konsideroj një rishikim të lehtë, nuk ka projekte të reja. Me këtë rishikim stabilizojmë përfundimin e projekteve ashtu siç janë planifikuar, po ashtu stabilizohet suficiti

në projektet në të cilat ka kosto më të ulët sesa planifikimi dhe stabilizohen projektet që kanë mbetje në krahasim me koston. Pra qëllimi i Drejtorisë është që me këtë rishikim të përfundojnë projektet, të mos ketë suficit dhe borxh publik.

z.Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DPUMM), theksoi, ne si Drejtori kemi ofruar propozimin për ridestinimin e mjeteve buxhetore që kanë qenë të planifikuara për këtë vit fiskal, duke bashkëngjitur edhe listën prej 29 projekteve. Vlen të theksohet se janë larguar tri kode - projekte dhe njëkohësisht janë futur 5 kode të reja që planifikojmë realizimin e tyre me këtë ridestitim të mjeteve. Kodet e reja rezultojnë prej kërkesave të qytetarëve të paraqitura në harmoni edhe me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2016-2018. *Në vazhdim drejtori në detaje arsyetoi dhe sqaroi propozimin për rishikim të buxhetit në kuadër të Drejtorisë.*

z. Fidan Rekaliu, Grupi i këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e LDK-së e përkrahim propozimin për rishikimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2016. Konsiderojmë se ridestnimi është paraparë konform Ligjit për Financat Publike dhe Përgjegjësit dhe në kuadër të këtij ridestnimi janë projekte shumë të rëndësishme të cilat ndihmojnë dhe lehtësojnë jetën e qytetarëve të Komunës sepse janë projekte të natyrave të ndryshme dhe si të tillë e përkrahim.

z. Rafet Llapashtica, në mbledhjen e KPF-së jemi sqaruar lidhur me dokumentin, në disa pika sidomos te kodet e reja ku kemi marrë edhe disa sqarime për të cilat më parë nuk kemi qenë të njoftuar për këto shuma që janë paraparë, duke përjashtuar kodin e ri për rrugën Ballaban – Orllan. Në bazë të dokumentit afër 1 milion € do të ridestinohen nëpër projekte të ndryshme. Grupi i këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës konsideron se është një shumë e konsiderueshme dhe është mungesë e projekteve adekuate. Ky dokument është i ligjshëm por jo të ketë ridestime në shuma aq të mëdha. Në mbledhjen e KPF-së me drejtorin z.Durim Salihu diskutuam edhe çështjen e projektit Ballaban – Orllan dhe jemi në dijeni se Ministria e Infrastrukturës e cila ka shprehë gatishmëri që të ndihmojë punimet në disa projekte të caktuara që ne e përshëndesim atë disponueshmëri, dua të them se ato mjete kalojnë për investime në Komunën e Podujevës dhe buxheti i Komunës shfrytëzohet sa më shumë, mirëpo nuk më ka pëlqyer mos puna e arkitektëve të Komunës dhe nuk e di se kush i mbikëqyrë ata, fjala është për një projekt të rrugës për të cilin janë ndarë 10,000.00€ në bazë të asaj që drejtori e deklaroi në KPF, e që unë mendoj se ajo shumë nuk është dashur të bartet në këtë kod për arsye se nuk e di se cila është detyra e arkitektëve komunal. Unë jam skeptik që edhe në të gjitha këto kategori të projekteve që kanë hyrë, besoj se nuk ka projekte, nëse ka shtroj pyetje konkrete për drejtorët e Drejtorive, dhe atë, a ka projekte ekzistuese për këto shuma të mjeteve buxhetore që do t'i bartim. Ne si Grup i këshilltarëve të PDK-së gjithëherë jemi për të investuar dhe nuk jemi kundër, mirëpo investimet duhet bërë në mënyrën më të mirë. Nëse 10,000 €, janë ndarë për projekt, arkitektët e Komunës që marrin pagë realisht nuk mund të paguhën, ne jemi të njoftuar se kush i bënë projektet në Komunë, cila kompani private, pastaj lidhshmërinë familjare të konfliktit të interesave mes drejtorëve dhe instancave të larta të qeverisjes, andaj është mirë që ky fenomen të eliminohet. Për shkaqe parimore nuk po flasim me emra dhe nuk dua të bëj debat personal me askënd por në mënyrë të përgjithshme e them, si qytetar dhe besoj se çdo subjekt është i thirrur që të japin kontributin e tij në këtë Kuvend, mirëpo nëse kjo dukuri nuk eliminohet obligohemi të tregojmë se kush e bën këtë projekt 10,000.00€. jemi në dijeni se Memorandumi është nënshkruar pak më vonë, mirëpo deri sa Ministria t'i përgatitë mjetet, mendoj se nëse

arkitektët kanë plan dinamik dhe mbikëqyrje, e bëjnë projektin, dhe 10,000.00€ nuk ka nevojë t'i japin kompanive private, sepse besoj që në qoftë se e kanë të kryer shkollimin ashtu si duhet, një projekt mund ta kryej për një periudhë të caktuar. Çështja tjetër, pasi është prezent edhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit, në mbledhjen e KPF-së kemi diskutuar edhe projektin për ndërtimin e objektit shkollor "Dituria", ku të gjithë kemi qenë për ndërtimin e asaj shkolle sepse jemi në dijeni me gjendjen e shkollës si është, unë personalisht e kam vizituar atë shkollë dhe besoj se të gjithë janë në dijeni se është në gjendje të rëndë, kemi pasur debat edhe gjatë debatit publik me Komuna dhe që ka qenë edhe Kryetari i Komunës, mirëpo kemi dashur të dimë se drejtori z.Avni Maloku a ka shikuar që këto mjete, pasi që për të ndërtuar shkolla është e thirrur Ministria e Arsimit, a ka deponua kërkesë dhe projekt në Ministri që të lirojë buxhetin komunal prej kësaj shume, e them këtë pasi që drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në mbledhjen e KPF-së theksoi se siç po shihet nuk është vullneti për ndërtimin e asaj shkolle, mirëpo absolutisht nuk është qëllimi ynë ky dhe nuk jemi kundër ndërtimit, madje denoncimi për gjendje të keqe për shkollat "Dituria" "Luigj Gurakuqi" dhe "Naim Frashëri", ka qenë nga Grupi i këshilltarëve të PDK-së, dhe jemi në dijeni për gjendjen reale, por problemi ka qenë se drejtori i Drejtorisë së Arsimit dhe ish drejtori pasi kanë qenë në dijeni, a kanë dërguar shkresë zyrtare në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për ndërtimin e asaj shkolle, nëse jo atëherë nuk e kanë kryer punën e vet. Ne duhet të japim kontributin tonë në interes të nxënësve ashtu siç e meritojnë, dhe për këtë të na tregojë drejtori i Drejtorisë përkatëse, nëse jo, ne po njoftohemi se nuk e ka kryer punën e vet, dhe na duhet të barikadohemi të gjithë për të kryer atë punën. Tjetër projekt kemi renovimin e Sallës së Teatrit të Qytetit, rialokimi i mjeteve prej fushës së hapur të sportit. Kuvendi, përfshirë Grupin e PDK-së e ka dhënë fjalën e vet pro ardhjes së buxhetit për ndërtimin e objektit palestrës së sporteve, çështja e pronës të cilën e kemi theksuar po atë ditë, edhe pas kërkesave të mediave që na kanë ftuar, ne kemi theksuar se është përgjegjësi e drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, më vonë më duket se ka dalë një reflektim i problemit me prona, drejtori është zotuar se prona është komunale, ish vendimi i marrë në mandatin e kaluar ka dalë në kundërshtim me Ligjin, por nuk dua të hyjë në ato çështje të mëhershme. Ne kemi kërkuar një takim të grupeve që ka qenë pjesëmarrës Drejtori i DBF, Kryesuesi dhe shefat e grupeve të këshilltarëve, pas vendimit për themelimin e Teatrit të qytetit të ndahet një shumë solide që të bëhet hapi i parë për Teatrin në Podujevë, përgjigja ishte se në 2016 nuk ka mjete, ndërsa tani propozohen për rialokim afër 90,000-100,000 € për renovim të një salle. Nëse merret një hap prej Nivelit Qendror për ta ndërtuar objektin e Teatrit atë duhet rrënuar menjëherë, sepse ndërtohet Teatri i ri dhe ato mjete i qojmë në dëm. Ushtruesi i detyrës së drejtorit të DKRS-së mendoj se është dashur të reflektoj në këtë rishikim. Për ndarje të mjeteve kemi kërkuar që të sjellë në Kuvend kërkesën për ndarje të mjeteve, e që nuk e ka sjellë, dhe po ta kishte sjellë me kohë kërkesën për themelim të Teatrit, që ka qenë hapi i parë për formësimin e Teatrit të Komunës së Podujevës ku ne si Kuvend njëzëri e kemi përkrahur propozimin për harmonizim të vendimit me ligjin, vendim i cili më parë ka qenë në kundërshtim me ligjin dhe gjithë Grupet kemi votuar për themelimin dhe harmonizimin me Ligjin që ka qenë në kundërshtim më herët, ndërsa tani me propozim për rishikim e sjellë propozimin për renovim të sallës, pra nuk shohë reflektim të ushtruesit të Detyrës së drejtorit të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit në këtë aspekt. Nëse ka reflektim për renovim të Sallës në shumë 90,000.00€, atëherë cili është reflektimi i drejtorit për Teatrin e Podujevës.

Si Grup i këshilltarëve nga radhët e PDK-së, brenda dokumentit shohim projekte që janë për tu mbështetë, mirëpo si shkas i mospunës konkrete, jo i tërësisë, e as subjektit LDK, por i përgjegjësve konkret që janë të thirrur në kontratë, po detyrohemi që për shkak të tërësisë së dokumentit, mos ta votojmë, jo që nuk e kalon LDK-ja pasi që i ka numrat, por si shkas i mos mbikëqyrjes konkrete, nuk e di cili drejtor i mbikëqyrë arkitektët kur brenda 3 viteve nga konstituim i Kuvendit nuk i ofrohet Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit një projekt i hartuar nga arkitektët e Komunës, ndërsa ne të ndajmë mjete për t'i paguar arkitektët privat, dhe nëse është e arsyeshme, unë e di që demokracia i ka numrat brenda Kuvendit dhe ne nuk mundemi të bëjmë asgjë më tepër, dhe jemi kundër formave tjera, mirëpo besoj se Kryetari i Komunës duhet të reflektoj dhe së paku në të ardhmen të jap punën e vet. Ne jemi kundër ndarjes së mjeteve për projekte kompanive private nëse ka arkitektë në Komunë. E kemi bërë kërkesë zyrtare dhe prap si Grup i këshilltarëve theksojmë se nëse nuk ka arkitektë në komunë, absolutisht është mbështetja e PDK-së që të punësohen 2 apo 3 arkitektë të cilët kryejnë punë për këtë Komunë, nëse gjenden forma financiare, absolutisht jemi për, mirëpo meqë Komuna ka arkitektë atëherë kërkojmë të kenë mbikëqyrje. Janë mbi 20 projekte që së paku neve si opozitë na kanë ardhur që janë projekte të hartuara privatisht, me mjete të qytetarëve dhe asnjë nga ata nuk realizohet. Vetëm i kanë detyruar të shpenzojnë, ndërsa arkitektët nuk e kanë kryer punën e vet, nga ana tjetër Drejtoria u thotë se pa pasur projekt nuk mund të ndërtohet rruga. Mendoj se nuk jemi duke bërë një punë bashkëpunuese e cila do të ishte në të mirë të qytetarëve, kështu që unë shtrova këto tri pyetje konkrete për drejtorët aktual, dhe nëse ata kanë përgjigje, mirë është të përgjigjen, jo mua personalisht, por Kuvendit dhe Kryesuesit të Kuvendit i cili e drejton këtë Kuvend.

z.Haki Rudari, theksoi, edhe Grupi i këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje ka analizuar propozimin për rishikim të buxhetit dhe ajo çka në parim e përkrahim është aspekti ligjor që vlen të rishikohet buxheti, mirëpo ajo çka fuqishëm e kundërshtojmë është ridestinimi i tyre, për arsye se është viti i tretë që prej se ne jemi pjesë e këtij Kuvendi dhe vazhdimisht kemi dhënë vërejtje dhe vazhdimisht na përcjellin këto gjëra nga qeveria komunale, se projektet kryesisht po shkojnë nga vijnë njerëz të LDK-së, dhe kjo është ajo që ne e kundërshtojmë, ne jemi për rishikim por kundërshtojmë fuqishëm mënyrën e ridestinitimit të mjeteve. Buxhetin e Komunës së Podujevës nuk e përbëjnë vetëm ata qytetarë ku shkojnë projektet, por buxheti i komunës kontribuohet nga të gjithë qytetarët kudo që jetojnë, andaj është mirë që investimet, projektet e ndryshme të zbatohen dhe të shndërrohen në fitimprurëse për qytetarët pa dallime të ndryshme politike. Ndarje të ndryshme, bursave, subvencioneve, pastaj bllokimi i trotuareve, mandej shndërrimi i shesheve në biznese, për këto përgjegjëse është qeveria komunale, dhe për këto është përgjegjëse LDK-ja e cila prej pas lufte e ka pushtetin, mirë që e ka pushtetin sepse e ka marrë me vota, por edhe kur është ana negative duhet të merr përgjegjësinë, dua të them duhet të pranohet si e mira si e keqja. Në rast se analizojmë një buxhet, për më shumë se 950,000.00€ për ridestitim, rreth 20% e buxhetit për investime kapitale të shumës së buxhetit për investime kapitale, gati 100% më shumë se sa vitin e kaluar kjo na tregon se qeverisja komunale nuk është duke punuar mirë, deri sa vitin e kaluar shuma e rishikuar ka qenë rreth 500,000.00€, sivjet i kemi rreth 950,000.00€, dhe në rast se të shkon të zvogëlohet ajo rritet, dhe kjo i bie që në vitin e ardhshëm ndoshta rishikimi i buxhetit do të shkoj në 2 milion euro, andaj kjo është ajo që ne e kundërshtojmë. U tha se janë projekte të rëndësishme, andaj nëse vërtetë është ashtu përse nuk kanë qenë projekte të

rëndësishme në fillim, në fletën e parë kemi 10 projekte dhe krejt këto paskan qenë të parëndësishme, kush e merr përgjegjësinë për këto, opozita, jo për këtë përgjegjëse është qeveria komunale. Sa i përket kodeve, u tha se figurojnë 5, ndërsa këtu janë 6 kode të reja, dhe ne kur kemi propozuar na është thënë se nuk ka mundësi për kode të reja kurse tani me këtë rishikim kemi 6 kode të reja. Po ashtu për ne shqetësuese është se merren trekatër projekte dhe krejt shuma e tyre shkon në një projekt – kod të ri, gjë e cila u tha edhe dje në KPF se është problem për qytetarët ta bëjnë atë projekt për shkak se ka pak banorë, kështu u tha në mbledhjen e KPF-së, ndërsa në anën tjetër qytetarët kanë projekte të shumta, më gjatë se dy-tri vite, projekte të cilat i kanë hartuar me mjete të tyre kurse nuk merren parasysh, pse nuk merren parasysh ato, kjo është çështje që duhet të epen përgjigje. Për fshatin Konushec, kanë qenë 50,000.00€ për investime dhe tani merren 11,038.00€ ku aty është kërkesë e banorëve edhe për dy rrugë anësore, dhe nëse nuk gaboje njëra rrugë anësore asfaltohet ndërsa tjetra jo, kjo është një investim selektiv e që ne e kundërshtojmë fuqishëm. Një çështje tjetër e cila për ne është gjithashtu e papranueshme, e që nuk është një shumë e madhe, rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave, ridestnimi i tyre, mendojmë se është dashur të ketë më shumë mjete për këtë çështje sepse varrezat kanë nevojë më të madhe për mirëmbajtje sidomos ato të Dëshmorëve, andaj nuk është mirë të merren mjete nga ai kod dhe të ridestnohen në projekte për shtruarje të rrugëve me zhavorr. Çështje tjetër është zgjerimi i sallës së Teatrit, ne kemi pas premtim të shumta për ndërtimin e Qendrës së Kulturës dhe në krejt në rregull, e përkrahim sepse Komuna jonë ka nevojë për Qendër të Kulturës, por ne kundërshtojmë se 176,482 € që janë për zgjerim të sallës së kulturës, ndoshta në vitin e ardhëm do të ndërtohet salla e kulturës, pra pse t'i investojmë këto mjete kur kemi shumë nevoja të tjera më të rëndësishme. Çështje tjetër që e kemi ngritë në KPF e ndoshta pak sa edhe polemik me drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave ka qenë kodi i ri për ndërtimin e objektit të shkollës së re në fshatin Llapashticë e Poshtme. Besoj se ju kujtohet por janë edhe shënimet ku ne kemi përmend se shkollat e fshatrave Bajçinë, Llapashticë kanë nevojë për investime, por edhe tani përkrahim fuqishëm ndërtimin e atyre objekteve, mirëpo e përkrahim në parim, por nuk di se a ja vlen të merren 230,963.00€ nga projekti për zgjerimin dhe renovimin e objekteve shkollore dhe të destinohen për ndërtimin e një shkolle kur ndoshta është mundësia të merren mjetet nga MASHT, dhe kjo ishte vërejtja që unë e bëra në mbledhjen e KPF-së, nuk jemi kundër ndërtimit të shkollave, përkundrazi, përkrahim ndërtimin e tyre, por e kam thënë që ndoshta do të ishte më mirë të kërkohen mjete nga MASH-ti, dhe këto mjete që janë të shkojnë në zgjerimin dhe renovimin e shkollave ku disa herë kemi biseduar për këtë çështje sepse vërtetë kanë nevojë shkollat për ndërhyrje, në të kundërtën pe përsërisë se në parim e mbështesim këtë sepse fshati Llapashticë e Poshtme ka nevojë emergjente për ndërtimin e shkollës. Prandaj kur krejt këto që u than i marrim parasysh mendoj që realisht ridestnimi prej afro 1 milion euro tregon se kemi pas të bëjmë me projekte jocilësore ose jo të qëlluara e tani ato projekte duhet të ripërsëriten ose duhet të merren. E përsëris nuk është mirë të bëhen investime selektive, ku ka raste ku bëhen investime pa pasur fare projekte nga ana e qytetarëve ndërsa ka raste ku bëhen projekte nga qytetarët por nuk merren parasysh, dhe kjo është ajo që ne e kundërshtojmë, dhe këtë formë të ridestnimit Grupi ynë i këshilltarëve do të votoj kundër.

z.Mirsad Kamerolli, theksoi, ky propozim vendim për redistinimin e buxhetit të Komunës është mjaft i qëlluar, veçanërisht për projektin e ndërtimit të objektit të shkollës në fshatin Llapashticë e Poshtme, projekt i cili ka pas nevojë të realizohet para tetë viteve, megjithatë

e përgëzojë Kryetarin e Komunës dhe Ekzekutivin e Komunës për ridestinimin e mjeteve për ndërtimin e atij objekti shkollor. Sa i përket këtij ridestini në përgjithësi, besoj se nuk ka diskriminim rreth projekteve, dhe që ridestini i projekteve është bërë në mënyrën më të drejtë të mundshme.

znj.Kumrie Hoti, theksoi, kam një propozim dhe dua ta sqaroj. Duke marrë parasysh gjendjen e rëndë sociale të një kategorie shumë të cënueshme të qytetarëve tonë (nënave vetushqyese), dhe pasi që jemi në një moment të rëndësishëm kur marrim vendime për rishikim të buxhetit. Me qëllim të lehtësimit dhe të përmirësimit të jetës së qytetarëve të kësaj kategorie dhe duke besuar thellë se do të mbështesni këtë propozim timin po ju drejtohem me këtë

Kërkesë për shqyrtim, të propozimit për nxjerrjen e vendimit për lirim të nënave vetushqyese nga pagesa e tarifave për fëmijët e tyre në institucionin për edukimin dhe arsimimin parashkollor në Podujevë.

Të gjithë jemi të vetëdijshëm për gjendjen e rëndë të nënave vetushqyese (kryefamiljare) numri i të cilave edhe në Komunën tonë është fatkeqësisht mjaft i madh. Nuk do shumë mend që ta kuptojmë se gjendja e tyre është mjaft e rëndë kur kemi parasysh mjedisin ku jetojmë, paragjykimet e stereotipet që janë prezentë për këto nëna, po them nëna sepse për mua është shumë më shumë kur dikush është nënë sesa kur thuhet gratë kryefamiljare. Numri i madh i tyre në skemën e asistencës sociale që në rastin tonë është 95 sosh, e pasqyron më së miri gjendjen e tyre. Në këtë grup kemi 29 nëna vetushqyese me gjithsejtë 32 fëmijë të moshës 0-5 vjet. Kjo moshë është moshë për institucionin parashkollorë (çerdhe) dhe besoj se një numër i tyre ndoshta edhe do të mund të punësohej por fakti se nuk kanë përkujdesje për fëmijët i privon ato nga kjo mundësi por edhe e drejtë elementare. Prandaj me këtë propozim ju lus që ta shqyrtoni mundësinë që përmes këtij rishikimi të buxhetit të ndajmë një shumë të mjeteve rreth 5,000.00€ me të cilat Komuna do të kompensonte Çerdhen për fëmijët që eventualisht do të përfitonin lirim nga kjo pagesë (sipas të dhënave të marra nga Çerdhja e Qytetit, në Komunën tonë kemi një rast të tillë, ku një fëmijë vijon çerdhen).

Lus Kryetarin e Komunës që duke u mbështetur në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28, dt. 04.06.2008, Ligjit nr. 02/L-52 mbi Edukimin e Parashkollor dhe në bazë të Statutit të Komunës së Podujevës të nxjerr një propozim vendim në lidhje me këtë çështje.

Kushtet për lirim nga kjo pagesë do të përcaktoheshin në vendim dhe me dispozita që do të vendoseshin aty, por tani vetëm desha të shfrytëzojë rastin të marr edhe pëlqimin tuaj për këtë iniciativë që mendoj se është e qëlluar në të mirë të nënave vetushqyese, që sado pak t'ju dalim në ndihmë, dhe në fund pres mbështetje nga Grupi i grave asambleiste që t'i përkrahim këto nëna vetushqyese.

z.Mehmet Gashi, theksoi, sa për sqarim, ne e kemi në planifikim dhe është në procedurë dhe hartim e sipër propozimi i Rregullores për taksa tarifa dhe gjoba komunale, pra në kontekst të atij dokumenti mund të diskutohet kjo çështje që e paraqiti parafolësja, mirëpo sot kemi mbledhje të jashtëzakonshme dhe kemi temën apo propozimin për rishikimin e buxhetit ku kemi të bëjmë me projekte konkrete, ndërsa tani nuk mundemi të merremi me çështje tjera.

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, dua të paraqesë dy arsye kryesore që kanë ndikuar në shumën e propozuar në dokumentin për rishikimin e buxhetit, që afërsisht është 1 milion €. Kjo nuk është diçka e jashtëzakonshme sepse ndodh që të ketë shuma më të vogla por edhe më të mëdha të mjeteve për ridestinim. Arsyet janë sepse që nga aprovimi i propozim buxhetit për vitin 2016 e deri tani kemi nënshkruar disa marrëveshje me Ministri të ndryshme të cilat i kanë bartur mjetet për investime në Komunën e Podujevës, edhe në disa nga ato projekte ne kemi paraparë t'i realizojmë me buxhetin e Komunës, kështu që kemi qenë të detyruar të bëjmë disa lëvizje. Arsye tjetër është se deri tani janë proceduar dhe janë nënshkruar disa kontrata me Operatorë Ekonomik për projekte, kontrata të cilat në bazë të procedurave të prokurimit kanë qenë më të favorshme në raport me shumën e planifikuar dhe natyrisht mjetet e mbetura i kemi planifikuar sipas këtij propozimi për rishikim të buxhetit. Jemi munduar që ato mjete të mbesin afërsisht në ato lokalitete dhe ju garantoj se nuk ka projekte selektive sepse një gjë të tillë nuk e lejoj, jam i bindur se nuk ka asnjë fshat apo lagje të pastër sa i përket mbështetjes së një subjekti politik, që sipas logjikës së Vetëvendosjes është lagja e jonë dhe këtu duhet të investohet. Elektorati në fshatra dhe lagje është i përzier dhe është e pamundur që ta kemi një fshat apo një lagje vetëm të një subjekti politik, andaj nuk është mirë të thuhet dhe të përdoren gjëra të tilla sepse janë çështje që nuk qëndrojnë. Sa i takon ndarjes së mjeteve për ndërtimin e objektivit të ri të shkollës në fshatin Llapashticë e Poshtme, ne çdo vit nga viti 2010 deri tani kemi bërë kërkesa në Ministrinë përkatëse për ndërtimin e objektivit të shkollës në fjalë mirëpo asnjëherë nuk ka hyrë në planifikimet buxhetore të Ministrisë, kështu që vlerësimet tona janë që të ndajmë këtë shumë të mjeteve, dhe mendoj se nuk ka prioritet më të madh se sa të investohet në ndërtimin e një objekti të ri shkollor, kur kemi parasysh se në çfarë gjendje është objekti i cekur. Fundja nuk është kjo hera e parë që ne investojmë në ndërtimin e objekteve shkollore, kemi bërë edhe një ndërtim tjetër me mjete të Komunës, pastaj kemi bërë edhe zgjerime të objekteve, zgjerim të hapësirave, kështu që nuk është diçka e re. Kërkoj nga të gjithë që ta votoni këtë propozim vendim për rishikimin e buxhetit për vitin 2016, sepse ky është buxhet i Komunës së Podujevës, për qytetarët e Komunës së Podujevës, përfaqësues të të cilëve jeni të gjithë, nuk është buxhet as i Kryetarit dhe Ekzekutivit të Komunës, por është buxhet i të gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës, andaj duhet ta përkrahni dhe mos ta politizojmë këtë sepse nuk ka asgjë politike në këtë çështje. Dokumenti përmban projekte të parapara, por edhe projekte të reja të cilat besoj se do të realizohen brenda afateve të parapara. Sa i përket çështjes së hartimit të projekteve, mendoj se punonjësit apo inxhinierët e Komunës tonë kanë aftësi të përgatisin dhe të hartojnë projekte mirëpo ato duhet të jenë të përgatitura nga kompani të licencuara, kështu që Komuna nuk ka të drejtë të hyjë në raporte të tilla, prandaj kemi ndarë një shumë të mjeteve buxhetore për hartimin e projekteve. Sa i takon konfliktit të interesit unë jam i gatshëm të bisedoj me secilin prej jush dhe jam shumë i vendosur që këtë dukuri ta luftoj deri në fund. Kam bërë vërejtje edhe viteve të kaluara dhe do të kujdesem maksimalisht që punonjësit e Komunës të mos bien në pozita të konfliktit të interesit, por nëse paraqiten raste, natyrisht ligjet ekzistojnë dhe do të hapen procedura, kështu që ju ftoj të gjithëve për bashkëpunim.

z.Haki Rudari, theksoi, Kryetari i Komunës paraqiti disa sqarime, por dua të them haptas se logjika e LVV është të investohet pa dallime politike. E dyta është se ne angazhohemi dhe përkrahim fuqishëm projektet që bëhen pa dallime politike. Kam një çështje për Kryetarin e Komunës, janë disa projekte të qytetarëve që i kanë përgatitur më shumë se

dy vite dhe nuk merren parasysh, në të njëjtën kohë dyshoj se qytetarët i kanë bërë këto projekte të cilat janë propozuar me këtë rishikim, tani merreni me mend në njërin anë qytetarët kanë bërë më shumë se dy vite projekte dhe nuk janë futur ndërsa në anën tjetër ato që janë futur në rishikim nuk dihet se a janë përgatitur projektet apo jo, pra kjo është dallim, kurse në KPF u tha se për një rrugë në shumë 110,000.00€ është projekt i madh dhe se për atë rrugë qytetarët e asaj ana nuk kanë mundësi ta hartojnë projektin, pra ky është shqetësimi jonë.

Kryesuesi i Kuvendit, e hedh në votim dokumentin e propozim vendimit sipas rendit të propozuar të ditës dhe rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pas votimit u konstatua se me 19 vota për, 3 vota kundër dhe 10 vota të përmbajtura u konstatua se u miratua propozimi i vendimit për rishikimin e buxhetit të Komunës për vitin 2016.

Mbledhja përfundoi në orën 10;50

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-43647
Podujevë,
25 maj 2016**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**